

VENDIM
Nr.5, datë 20.10.2006

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË SUBVENCIONIMIT TË NDËRMARRJEVE TË
UJËSJELLËSIT

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me shkresën nr.4329/4, datë 16.8.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/014/2005.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13 shkronja c dhe nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, në nenin 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005, si dhe nenin 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme, në procesin e transferimit të së drejtës së pronësisë së ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt pushtetit vendor, duhet të marrin parasysh subvencionimin e këtyre ndërmarrjeve për ofrimin e shërbimit publik.

2. Masa e subvencionit të zvogëlohet në mënyrë progresive, të jetë e kufizuar në kohë dhe vlera e subvencionit të jetë në përpjesëtim me mangësitë që kërkon të rregullojë kjo lloj mbështetjeje. Pra subvencioni të jepet pas një analize të plotë dhe të saktë të treguesve ekonomiko-financiarë të secilës prej ndërmarrjeve dhe të mbulojë kryesisht shpenzimet për investime.

3. Subvencioni nuk duhet të tejkalojë kostot e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimit publik dhe, në këtë rast, ofrimi i shërbimit duhet të ketë llogari të ndarë, për të shmangur çdo lloj mbikompensimi. Për përcaktimin e tarifave, rast pas rasti, dhënësit e ndihmës (MPPTT dhe organet e pushtetit vendor) duhet të bashkëpunojnë me Entin Rregullator të Ujit.

4. Subvencioni për ndërmarrjet e ujësjellësit të përcaktohet nga dhënësit e ndihmës mbi bazën e kostos që do të kishte një ndërmarrje efiçente që do të ushtronte veprimtarinë në këtë sektor.

5. MPPTT dhe Ministria e Brendshme brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e këtij vendimi, të njoftojnë me shkrim pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore pranimin e masave të propozuara. Nëse nuk janë dakord me ndonjërin prej këtyre masave, brenda të njëjtit afat, të japin me shkrim argumentet përkatëse.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli